# DËSHMI ARKIVI

**A-479594**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Të dyshuar për krime lufte, 9 të arrestuar në Kosovë. Operacioni i policisë në Zubin Potok lidhet me “grupin e intelektualëve” \| Gazeta Shqip |
| ADRESA | `https://gazeta-shqip.com/kosova/te-dyshuar-per-krime-lufte-9-te-arrestuar-ne-kosove-operacioni-i-policise-ne-zubin-potok-lidhet-me-grupin-e-intelektualeve/` |
| BURIMI | gazeta-shqip.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 14:35:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 18:01:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7bf44aa324380d9b50c9ac007da9389a356e1acc970d2c71c7ecd934240b4322` |
| TEKSTI | `7b0e19796bdb23e28f4a6a8a0dcdfc4630d31b25cb3cb96fe6085cbdb8adf205` |
| PAMJA | `ba5f75cc7f65cb844a1d16656b942d6192f54f47561a9412b08e3766525129d4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fade008b11dd8202a3099f958863718de37574bfcec39949b5a08441bfccf75b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `da6b05e5b6a4871f38e77322a1aea555a613f6543c156d05714d243b2008ce80` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fade008b11dd8202a3099f958863718de37574bfcec39949b5a08441bfccf75b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Të dyshuar për krime lufte, 9 të arrestuar në Kosovë. Operacioni i policisë në Zubin Potok lidhet me "grupin e intelektualëve"




17:01 | 27 SHTATOR 2026

SHPËRNDA

Nëntë persona janë arrestuar në Zubin-Potok, nën dyshimin se janë përfshirë në krime lufte kundër popullsisë civile gjatë luftës në Kosovë.

Operacioni, i koduar "Dosja 23", u zhvillua në orët e para të mëngjesit nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës, në bashkëpunim me njësitë e tjera të specializuara të Policisë së Kosovës dhe me urdhër të Prokurorisë Speciale.

Sipas autoriteteve, të arrestuarit dyshohen për veprën penale "Krime lufte kundër popullsisë civile".

Hetimi lidhet me rastin e njohur si "Grupi i Intelektualëve të Mitrovicës", i përbërë nga 23 persona, mes tyre mjekë, profesorë, avokatë dhe profesionistë të tjerë, të cilët rezultojnë të zhdukur që prej prillit të vitit 1999.

Në fund të korrikut, në zonat e Kalludrës dhe Jabukës nisën gërmimet për gjetjen e mbetjeve mortore. Operacioni përfundoi më 21 gusht, ndërsa gjatë kërkimeve u gjetën mbetje që dyshohet se u përkasin 23 personave.

Pas këtyre zbulimeve, hetimet e Prokurorisë Speciale dhe Policisë së Kosovës janë zgjeruar për të dokumentuar rrethanat e vrasjes dhe zhdukjes së personave të këtij grupi.

Nëntë arrestimet në Zubin-Potok përbëjnë një zhvillim të rëndësishëm në

Këto arrestimet në Zubin Potok përbëjnë një zhvillim të rëndësishëm në hetimet për zbardhjen e fatit të "Grupit të Intelektualëve të Mitrovicës" dhe identifikimin e personave të dyshuar për përfshirjen në këto krime.


**GAZETA SHQIP**

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

**TOP ALBANIA RADIO**

News
Shows
Video
Podcasts

**MORE**

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

**SOCIAL**

**Newsletter**

Email...
Regjistrohu

Privacy Policy & Terms of Use | Cookie Policy

gazeta shqip


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.